



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ZVEÇANIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Zveçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Zveçanit (Komuna e Zveçanit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Zveçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Mangësi në prezantimin e të dhënave në PFV.

A1 Përmes pagesave direkte nga Thesari, bazuar në vendime gjyqësore, dhe urdhërave përmbartimore gjatë vitit 2024, transaksione në vlerë 74,246€, ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Zveçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A2 Komuna nuk kishte themeluar komisionin për Inventarizim dhe vlerësim të pasurisë jo financiare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKF është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKF është përgjegjës

edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Zveçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Zveçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Zveçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Zveçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë

për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Zveçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mangësi në prezantimin e të dhënave në PFV

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistrat kontabël të saktë, te plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Nga rishikimi i PFV-e kemi vërejtur se ato nuk i prezantojnë të gjitha informatat financiare për periudhën raportuese dhe periudhën krahasuese si dhe shpalosjet përkatëse. Disa nga mangësit e identifikuar janë:

- Mungojnë informata për Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet kontigjente.
- Komuna nuk kishte të regjistruara pasuritë jo financiare me vlerë nën 1,000€ në modulën e-pasuria e poashtu edhe stoqet nuk janë prezantuar në PFV.

Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhur për arsye të pamundësisë për t'i konsoliduar të gjitha këto informacione brenda periudhës kohore deri në raportim, si dhe vështërsive për të rekrutuar staf profesional dhe për t'i funksionalizuar sistemet përkatëse informative për sigurimin e informatave financiare dhe jo financiare.

Ndikimi

Mangësit në prezantim të PFV-ve, pamundësojnë që lexuesit të kuptojnë gjendjen e saktë të Komunes. Po ashtu, mungesa e informatave të plota në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se PFV për vitin 2025 janë të plota dhe të sakta, si dhe janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme para pregaditjes së tyre në mënyrë që ato të jenë të plota dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në komunën e Zveçanit përmes pagesave direkte nga thesari bazuar në vendime gjyqësore, dhe urdhrave përmbartimore gjatë vitit 2024 transaksione në vlerë 74,246€, ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 23,097€, nga mallrat dhe shërbimet 14,000€, si dhe nga subvencionet 37,149€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mos inventarizimi i pasurive jo financiare

Gjetja Sipas Rregullores me Nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 4 paragrafi 6, kërkon që “Zyrtari Kryesor Administrativ themelon Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Komisionin për Inventarizim të Pasurisë jo Financiare”.

Komuna nuk kishte themeluar komisionin për Inventarizim dhe vlerësim të pasurisë jo financiare. Në mungesë të themelimit të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit i cili do të verifikonte fizikisht ekzistencën e tyre si dhe gjendjen aktuale të pasurive të evidentuara në regjistrin e pasurisë saktësia dhe plotësia e informatave për pasurinë jo financiare të prezantuar në PFV është në nivel jo të kënaqshëm, dhe nuk mund të bëhet harmonizimi i regjistrave të pasurisë me gjendjen e tyre në PFV.

Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhur për arsye të mungesës së informatave financiare të trashëguara nga qeverisja paraprake, si dhe stafit të pa trajnuar dhe të pa çertifikuar.

Ndikimi Mos themelimi i komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat të Komunës dhe në PFV të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e paligjshëm të pasurisë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë themelimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive në mënyrë që para përgatitjes së PFV-ve të marrë sigurinë e nevojshme se pasuria jo financiare e komunës ekziston është e plotë dhe është e paraqitur në mënyrë të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 62,000€, përderisa ishin realizuar 6,982€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024.

Çështja C1 - Mos zbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në prone

Gjetja Neni 12 i ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme I i ligjit nr. 06/L-005, respektivisht paragrafi 2 përcakton se “Komuna ka përgjegjësitë si në vijim:

- Komuna regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor;
- lëshon faturat e tatimit;
- mbledh dhe përdor masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve të tatimit në pronë;
- shqyrton dhe vendos mbi kërkesat për shtyrjen e pagesës së detyrimeve tatimore.

Në PFV të vitit 2024 komuna nuk ka paraqitur të hyra të mbledhura nga tatimi në pronë dhe nuk ka planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë as në buxhetin e vitit 2025. Përkundër faktit se komuna e Zveçanit nuk kishte trashëguar regjistër të pronave nga qeverisja paraprake komunale, gjatë pjesës së dytë të vitit 2024, komuna kishte filluar të trajnoj stafin për të krijuar një regjistër komunal që shërben si bazë e të dhënave për tatim në pronë. Pos kësaj komuna ka filluar të ndërmarr veprime për identifikimin dhe regjistrimin e pronës fillimisht përmes sesioneve informuese, si dhe verifikimin e tyre nga zyrtarët komunal. Deri në muajin maj të vitit 2025 komuna kishte regjistruar rreth 3,000 tatimpagues në sistemin PROTAX për tatim në pronë.

Sipas zyrtarëve komunal kjo kishte ndodhur për arsye të mungesës së shënimeve paraprake si dhe mungesës së stafit të trajnuar për të zbatuar këtë kërkesë ligjore.

Ndikimi Mos zbatimi i Ligjit dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, ka pasur një ndikim të rëndësishëm dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të komunës duke mos pasur mundësi të gjenerimit të të hyrave nga kjo kategori e rëndësishme e tatimit komunal.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të shtoj përpjekjet që të identifikohen dhe regjistrohen në data bazën e tatimit në pronë të gjithë tatim paguesit e

komunës, në mënyrë që të hyrat komunale të rriten dhe qytetarët të kuptojnë rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë prej tij duke iu kthyer atij komuniteti në investime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	3,278,670	2,229,448	2,098,802	681,444	1,846,175
Grante Qeveritare – Buxheti	3,216,649	2,066,113	2,008,827	681,444	1,752,467
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	27,594
Të bartura nga viti i kaluar	0	35,082	34,274	0	46,755
Të hyrat vetanake	62,021	62,021	35,895	0	19,358
Donacionet vendore	0	2,360	2,360	0	0
Donacionet e jashtme	0	63,871	17,446	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,049,222€. Kjo zbritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë.

Komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 2,098,802€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2024, komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore ju kanë ekzekutuar rreth 74,246€ nga kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	3,278,670	2,229,448	2,098,802	681,444	1,846,175
Pagat dhe mëditjet	1,821,297	934,063	913,756	530,615	1,192,194
Mallrat dhe shërbimet	350,000	332,787	272,966	140,595	194,322
Komunalitë	65,000	17,156	15,501	7,234	5,666
Subvencionet dhe transferet	110,000	134,455	108,005	3,000	126,755

Investimet Kapitale	932,373	810,986	788,575	0	327,238
---------------------	---------	---------	---------	---	---------

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 887,234€. Vlen të cekët se me buxhetin fillestar ishte parashikuar mbulimi i pagave për drejtori të ndryshme përfshirë këtu shërbimet e shëndetësisë primare si dhe arsimin e mesë të lartë, stafi i të cilave ishte planifikuar të jetë dukshëm më i lartë por në pamundësi të mbulimit të këtyre pozitave me staf buxheti ishte zvogëluar me Vendim të Qeverisë.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 17,213€. Ky zvogëlim vjen nga Vendimet e Qeverisë.
- Buxheti final për komunalit, krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 47,844€. Ky zvogëlim vjen nga Vendimet e Qeverisë.
- Buxheti final për subvencioni ishte 110,000€, kurse buxheti final ishte 134,455€, kjo rritje e buxhetit final ishte ndikuar nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 në vlerë prej 30,324€ si dhe nga donacionet në vlerë prej 359€.
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 121,387€. Ky zvogëlim vjen nga Vendimet e Qeverisë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 62,000€, përderisa ishin realizuar 6,982€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat jotatimore respektivisht nga taksat administrative për shërbimet e ofruara komunale ndaj qytetarëve. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 100,177€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	62,021	62,021	6,929	1,336	1,575
Të hyrat jo tatimore	62,021	62,021	6,929	1,336	1,575

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tri (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim pjesërisht është zbatuar si dhe një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se PFV për vitin 2024 janë të plota dhe të sakta, si dhe janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme për përgatitjen e tyre.	Edhe në këtë vitë kanë pasur probleme me prezentimin e të dhënave në PFV.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmarr veprime për funksionalizimin e shërbimit të tatimit në pronë, hartimin e një	Komuna ka filluar të ndërmarr	Pjesërisht i zbatuar

		rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shumës së tarifave dhe gjithashtu përmes komunikimit të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë qytetarët prej tij.	veprime për identifikimin dhe regjistrimin e tatimpaguesve, por edhe më tutje duhet të përmbillet i tërë procesi i regjistrimit të të gjithë tatimpagusve në sistemin e protaxit.	
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar, vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, për siguruar që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



Muharrem Qyçalla, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA E ZVEÇANIT
Opština Zvečan – Municipality of Zvečan
Zyra e Kryetarit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Zveçanit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ilir Peci, Kryetar i Komunës

Data: 14.Maj. 2025, Zvečan,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.